

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i të miturve, gjykatë e shkallës së parë penale, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtaren Kadrije Goga-Lubishtani, kryetar, dhe gjyqtarët porot Lumturije Ibrahimimi dhe Zeqir Zeka, anëtar, me sekretaren juridike Florije Jakupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh.T., me nofkën “F....” nga Ferizaj rr. ”.....” kati i .. nr. për shkak të veprës penale keqtrajtimi apo braktisja e fëmiut nga nen 250 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Themelore në Ferizaj, PP.I. nr. 121/2013 të datës 03.shtator 2013, në shqyrtimin e mbyllur gjyqësorë të mbajtur me 21.1.2015 dhe shpalljen e aktgjykimit me datën 23.1.2015, në praninë e Prokurorit Burim Çerkini, të akuzuarit, mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Jakup Ramadani, përfaqësuesit ligjor të dëmtuarës- nënës së tij B.T., mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

SH.T., me nofkën “F....”, nga i ati F.T. dhe e ëma B., e gjinisë D., data lindjes në fshatin Komuna e Maçellar R. E Shqipërisë, me vendbanim në Ferizaj rr.”.....” banesa e solidaritetit kati i .. nr. shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës dhe të Shqipërisë, ka të kryer shkollën e lartë të Akademisë Ushtarake, pensionist invalidor, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar baba i dy fëmijëve, gjendet në paraburgim nga data 17.7.2013,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 17.07.2013 rreth orës 15.20 rreth orës 15.20, në rrugënnë Ferizaj, në banesën e tij në katin e ...-të nr. duke ushtruar autoritetin prindor, e ka keqtrajtuar fëmiun e tij F.T. i moshës 14 vjeçar, duke përdorur masa fizike dhe mendore, në atë mënyrë që të dëmtuarit F.T. në fillim ia ka lidhur duart me një shirit izolues-ngjitës dhe

me një kabëll të kompjuterit e ka rrahur duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit, në prainë të fëmiut M.T. dhe me pretekst se i njejt i ia ka vjedhur një palë dana të ujit, e pastaj ka tentuar që të ia lidh edhe këmbët, kështu që fëmiu nga frika ik dhe del në ballkonin e banesës, me duart e lidhura dhe tenton që të kaloj në terasën e fqiu, ku këmbën e majtë e vendos në murin e terrasës, ndërsa këmbën e djathtë në murin ndarës të terrasës me fqiu, ndërkaq, i akuzauri tenton që ta kap për rrobën e trupit-maicë, por fëmiu rrëshqet teposht duke rënë në mbulojën e katit përdhes të banesës dhe merr lëndime të rënda trupore dhe atë trauma të shumfishtë epifiziologjike e kockës së parakahut (radiusit të djathtë) thyerje e degëzimit të sipërm dhe të poshtëm të kockës publike (legenit), të anës së djathtë, thyerje e kockës së legenit (osischi) të anës së majtë, thyerje kockës sakrale (bishtit), përdredhje e gishtit të katërt të dorës së djathtë, ndrydhje hemorragjike e mushkërive në të dyja anët, përdredhje e thembrës së këmbës së djathtë, ndrydhje e barkut si dhe plagë shqyese ndrydhëse në regjionin ballor të kokës, të cilësuar si lëndime të rënda trupore,

Me të cilën krye veprën penale keqtrajtimi apo braktisja e fëmiut nga nen. 250 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-ës.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit 250 par. 5 lidhur me par. 1 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 45, 73, 83 të KPRK, dhe neni neni 365 të KPPRK –së, e

G J Y K O N

ME DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 3 /tri/ vite, në të cilin do të i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 17.07.2013 e tutje.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit- F.T.- nëna B.T., për kërkesën pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

OBLIGOHET i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 150/ njëqindë pesëdhjetë/ €, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 /pesëdhjetë/ €, të gjitha në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I. 1212013 më datë 03.09.2013, ndaj të akuzuarit Sh.T., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 179 par. 1 pika 1.1 dhe 1.3, lidhur me nenin 28, dhe për veprë penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.2 lidhur me par 1. të KPRK-së.

Në këtë Gjykatë është mbajtur shqyrtimi fillestar, siç parashihet në dispozitat e KPPK-së,që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprat penale që i vihen në barrë me aktakuzën e prokurorit të shtetit.

Gjatë zhvillimit të procedurës penale, nuk janë paraqitur kundërshtime të provave dhe nuk është paraqitur kërkesë për hedhjen e aktakuzës, siç parashihet në dispozitat e nenit 249 e250 të KPPK-së, andaj procedura ka vazhduar me shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale.

Pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore, në fazën e ndryshimit dhe zgjerimit të aktakuzës, prokurori i shtetit, e ka ndryshuar aktakuzën në drejtim të cilësimit juridik të veprës penale sa i përket pikës I të akuzës, përkatësisht nga vepra penale e vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 179 par.1 pika 1.1 e 1.3 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në atë mënyrë që të akuzuarin Sh.T. e ka akuzuar për kryerjen e veprës penale keqtrajtimi apo braktisja e fëmiut nga neni 250 par.5 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me aktgjykimin e saj PKR.nr.15/2014 të datës 18.09.2014, shpalli fajtor të akuzuarin Sh.T., duke i shqiptuar dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 4 vite e 6 muaj.

Gjykata Apelit e Kosovës, me aktvendimin e saj të PAKR.nr.526/14 dt. 11.11.2014, ka aprovuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit ashtu që ka anuluar këtë aktgjykim dhe çështjen e ka kthyer për rigjykim.

Kjo çështje juridiko penale ka kaluar në kompetenc lëndore në Departamentit për të mitur të Gjykatës Themelore në Ferizaj, i cili me aktvendim të veqant PKR.208/14,me dt.21,01,2015, ka veqar procedurën për veprën penale mbajtaj në pronësi kontroll dhe

posedim të pa autorizuar të armëve nga nen.374 par.2 lidhur me par.1 të KPRK –së pasi që konform nen.145 të KDM-së nuk është i përfshir në këtë grup të veprave penale ku është kompetent për të gjykuar Trupi Gjykes për të mitur, kurse sipas të njëjtës aktakuzë të ndryshuar (në shqyrtimin e kaluar gjyqësor), ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor vetëm për veprën penale keqtrajtimi apo braktisja e fëmiut nga neni 250 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, me dt. 21.01.2015, kurse në fjalët përfundimtare të palëve Prokurori i Shtetit Burim Çerkini ka mbetur në tërësi si në aktakuzën e ndryshuar, duke deklaruar në fjalët përfundimtare, se me të gjitha provat është vërtetuar fajësia e të akuzuarit për kryerjen e veprave penale, i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin Sh.T. t'a shpall fajtor për këto vepra penale të cilat i ka kryer dhe të i shqiptohet një dënim i parapara me ligj.

Përfaqësuesja e të dëmtuarit F.T. - nëna e tije B.T.,në fjalët përfundimtare të palëve, ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit, ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, të cilën do ta realizon në procedurë të veçantë.

I akuzuari Sh.T., në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet me aktakuzën.

Në mbrojtjen e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se ditën kur ka ndodhur rasti ,pra më datë 17.07.2013,fëmijët e tij e F.T. e M.T., kishin shkuar tek dajët e tyre në fshatin të Ferizajt, për të vizituar nënën e tyre(bashkëshorten e të akuzuarit me të cilën e kishin shkëputur bashkësinë martesore),i ka ftuar përmes telefonit dhe kur janë kthyer në banesë në Ferizaj,i akuzuari e ka pyetur djalin e tij F.T. lidhur me një palë dana për prerjen e llamarinës që i kishin humbur më përpara, si dhe rreth një rasti të vjedhjes të ndodhur më parë, e që F.T. ishte i involvuar bashk me një shok të tij, e që i akuzuari rreth kësaj vjedhjeje ishte njoftuar nga ana e policisë.

Ka deklaruar në mbrojtjen e tij, se ka filluar ta qortoj fëmiun e tije F.T. për këto veprime, e ka rrahur me një kabëll të kompjuterit, ia ka lidhur duart me një shirit izolues, deri sa qëndronin në dhomën e banesës, e në një moment i akuzuari ka dal prej dhomës për të marr çelësat në derën e hyrjes së banesës, dhe ka vërejtur F.T. që është larguar nga dhoma duke dalur në terasën e banesës, e që i akuzuari ka shtuar se ka shkuar prapa tije dhe ka parë se F.T. ka hipur në murin e terasës, duke e vendosur njërën këmbë të majtën në mur, kurse këmbën e djathtë e ka vendosur në murin ndarës të terasës me fqijun, kurse me duart e lidhura mbahej për shtyllën e hekurit që e mban terasën.

Me të vërejtur këtë situatë, ka deklaruar i akuzuari e duke pas parasysh pozitën e murit ndarës të terasës së fqijut, pozitë e pjerrët me ramje të pjerrtësisë nga ana e jashtme që si pozitë e tillë jep mundësinë që pjesa e përparme e trupit të anoj jashtë terasës, i akuzuari theksoi se është munduar që ta qetësoj fëmiun duke i thënë “mos F.T., ndalu” etj, dhe është munduar që ta kap për rrobën e trupit-maicë, por ka arritur që vetëm me gishtat e dorës ta kap, me qëllim që ta tërheq nga vetja, por fëmiu ka rrëshqitur teposhtë duke rënë nga terasa e banesës që gjendet në katin e shtatë të ndërtesës, ka zbritur me të shpejtë poshtë, por fëmiun e kishin dërguar në Emergjencën e Spitalit në Ferizaj, e pastaj në QKUK në Prishtinë.

Ka deklaruar se fëmiun F.T. e ka rrahur ditën kritike, me qëllim edukimi, meqë fëmiu kishte sjellje devijuese, merrej me vjedhje, nuk vijonte mësimet në shkollë, ishte larguar nga banesa duke mos e ditur i akuzuari se ku strehohej e për këtë kishte njoftuar edhe policinë, dhe në përgjithësi veprimet e ndërmarra ndaj fëmiut të tije i kishte marr me qëllim që ta largoj nga vetitë dhe sjelljet e veprimet devijuese, në tutje shton se asnjëherë nuk i ka lënë pa përkujdesje, ai është kujdesur meqë nëna e të miturit- bashkëshortja e tij ka qenë e sëmurë dhe ka jetuar në familjen e saj në fshatin, dhe ai edhe ka gatuar buk për fëmijët e tij. Iu ka blerë veshmbathje dhe gjëra tjera të nevojshme për fëmijët aq sa ka pasur mundësi.

I ka propozuar gjykatës që ta liroj nga akuza.

Me që i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas pretendimeve të aktakuzës se prokurorit , gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka bërë paraqitjen e provave, të cilat i vlerësoi një nga një dhe ne ndërlihdje reciproke me njëra tjetrën, duke gjetur kështu bazën e aktgjykimit dhe duke e vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale.

Gjykata, gjendjen e tillë faktike e vërtetoi me provat e paraqitura ne shqyrtimin gjyqësor dhe atë :

- Pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarit Sh.T., të dhënë në procedurë paraprake dhe në shqyrtimin gjyqësor, dhe pjesërisht nga dëshmitë e dëshmitarëve F.T., M.T. dhe B.T.,
- Nga ekspertiza mjekoligjore lidhur me natyrën e lëndimeve për të dëmtuarin F.T., nr...../13 të datës 02.09.2013,
- Nga raporti për vëzhgimin e vendit të ngjarjes nr...-07-2013 të datës 16.07.2013 dhe nr.49-08-13 të datës 21.08.2013,
- Procesverbali për kontrollimin e banesës nr.2013CF..... të datës 17.07 dhe 29.07.2013.
- Procesverbali i përpiluar nga kryeri i trupit gjykues dhe anëtarëve tjerë, në vendin e ngjarjes me date 22.04.2014,

Trupi gjykues vlerësoi provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe konstatoi:

- se është arritur që plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të vërtetohet gjendja faktike e ndodhur me datë 17.07.2013 në banesën në rrugën “” në Ferizaj kati ..-të, numër

Në këtë kuptim trupi gjykues fillimisht vlerësoi se janë vërtetuar në mënyrë të pa kontestueshme këto fakte:

- se ditën kritike tani i akuzuari Sh.T. në banesën e lartcekur femiut të tij – të dëmtuarit F.T., ia ka lidhur duart me ngjitës izolues dhe e ka rrahur me një kablo të kompjuterit,
- se tani i dëmtuari F.T. ka rënë nga terasa e katit të ..-të të banesës dhe me këtë rast ka marr lëndime të rënda trupore.

Këto fakte u vërtetuan gjatë procedurës penale me të gjitha provat materiale dhe me dëshmitë e dëshmitarëve F.T. e M.T. si dhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit Sh.T..

Trupi gjykues, pasi vlerësoi gjithanshëm të gjitha provat, vërtetoi pa dyshim gjendjen faktike të përshkruar si ne dispozitiv të aktgjykimit.

Se ditën kritike të datës 17.07.2013, i akuzuari ia ka lidhur duart me shirit izolues djalit te tij femiut F.T., e ka rrahur me kablllo të kompjuterit, fakt ky qe nuk është mohuar as nga i akuzuari në mbrojtjen e tij të dhënë në të gjitha fazat e procedurës penale, përfshirë edhe mbrojtjen e dhënë në shqyrtimin gjyqësor “ *unë kam filluar ta qortoj, e kam godit me kablllo të lap topit, ia kam lidh duart me izolir ...* ”¹.

Se tani i dëmtuari F.T., me duart e lidhura, nga dhoma ku ishte, ka dal në terasën e banesës, ka hipur në murin e terasës duke e vendosur këmbën e majtë në murin e terasës, me duar duke u mbajtur për shtyllën metalike, ndërkaq këmbën e djathtë e ka vendosur në murin ndarës me terasën e fqiu, dhe në këtë pozitë në momentin kur i akuzuari ka tentuar ta kap për rrobën e trupit femiu ka rrëshqitur dhe ka rënë poshtë terasës, “ *kur e vërejtja se F.T. doli në teras te banesës, unë menjëherë kam shku atje dhe e kam vërejt se këmbën e majte e kishte në murin e terases, me duar mbahej për shtylle metalike, këmbën e djathte ka tentuar qe ta vendos në murin qe i ndanë terasat, qe muri është i pjerrët me ramje nga ana e jashtme e terases dhe vet kjo pozitë e murit dhe vendosja e këmbës së djathtë në këtë muri e jep mundësinë qe pjesa e epërme e trupit të del jashtë terase.... e kam pa se me pjesën e epërme të trupit është shkëput prej terases, duart i kanë rrëshqit prej direktut të metalit, e unë edhe pse ishin sekonda të shpejt, jam mundu me kap për maice në pjesën e shpinës por vetëm me gishtat e dorës e kam kap dhe i njëjti rrëshqiti dhe ra poshtë*”².

Edhe i dëmtuari F.T., i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit ka përshkruar në mënyrë të përafërt situatën e ndodhur ditën kritike “ *babai ka kërkuar nga unë, ku i kam lan danat, mi ka lidh duart me izolir me ka godit me kabell të rrymës, dhe ka dasht me mi lidh edhe këmbët... kam ik prej sallonit kam dal në ballkon të banesës, për me dal në terasën e fqiu, njëherë këmbë e kam qit në murin e terases, këmbën tjetër në murin qe e ndanë ballkonin me fqiu*”³, për të vazhduar më tutje “ *baba im Sh.T. më ka tërheq ka vetja, ka qenë në teras të banesë, kurse unë isha në murin që ka nda dy terasat, edhe para këtij rasti unë e kam kaluar murin e ballkonit dhe kam dal në terasën e fqiu, duke vendos njanen kamb në murin e terases*

¹ Mbrojtja e të akuzuarit Sh.T. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me date 17.06.2014

² Po aty si në fusnotën numer 2,

³ Pjesë e deklaratës së dëshmitarit F.T. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor te dates 17.06.2014

e kemben tjetër në murin që i ka nda terasat, kështu edhe ate ditë mendova se lehtë do ta kaloj murin për të dal në terasën e kojshiut”⁴.

Gjendja e tillë faktike e përshkruar nga i dëmtuari dhe nga i akuzuari nga ana e trupit gjykues u vlerësua si reale sepse vërtetohet edhe me provat e tjera, siç janë përshkrimi i vendit të ngjarjes nga policia me rastin e vëzhgimit pas ndodhjes së rastit, e po ashtu edhe me shiqimin e drejtpërdrejt në vendin e ngjarjes nga ana e trupit gjykues të bërë me datë 22.04.2014 në banesën numër ... kati i ..-të konkretisht në terasën e kësaj banese, me ç’rast u vërtetua drejtpërdrejt gjendja e mureve të ballkonit dhe atë muri i jashtëm në një lartësi prej 90 cm dhe muri tjetër që ndanë këtë terasë me terasën tjetër të fqiut që fillon prej lartësisë 90 cm nga ana e jashtme me një pjerrtësi deri në përfundimin e murit nga ana e brendshme pra në një lartësi prej rreth 2.40 metra, kurse në piken ku takohen këto dy mure gjendet shtylla e metalit që e mban qatinë e terases.

Dëshmitë e dëshmitares M.T. dhe të dëshmitares B.T. sipas bindjes së trupit gjykues nuk e ka ndryshuar në asnjë mënyrë gjendjen faktike dhe të provuarit e veprës penale, sepse dëshmitarja B.T. konkretisht në dëshminë e saj i është referuar me tepër raporteve bashkëshortore me të akuzuarin dhe prishjen e këtyre raporteve, kurse dëshmitarja – femiu M.T. i referohet më tepër fillimit të ngjarjes pra kur i akuzuari ka filluar ta rrah të dëmtuarin F.T. por jo edhe veprimeve të tjera të ndodhura me rastin kur i dëmtuari ka rënë nga terasa teposhtë.

Përfundimin konkret se i akuzuari Sh.T. është kryes i veprave penale që i vihen në barrë me akuzën e prokurorit të shtetit, trupi gjykues e nxori nga provat që u ceken në pjesën vlerësuese të provave dhe me këtë konstatoi se teza e paraqitur nga i akuzuari dhe mbrojtësi i tij për pafajësinë e të akuzuarit nuk qëndrojnë, dhe si të tilla janë të pa argumentuara.

Si të shpjegohet ndryshe fakti i keqtrajtimit të femiut, lidhja e duarve me izolir dhe rrahja me kablo nga i akuzuari, dhe për të shpëtuar nga kjo gjendje i dëmtuari – femiu largohet nga dhoma duke tentuar që të kaloj në terasën e fqiut, duke menduar kështu që të shpëtoj nga situata meqë edhe më përpara këtij rasti siç ka deklaruar vet e ka ndër marr këtë veprim pra e ka kaluar murin por në rrethana të qeta dhe pa presionin e prindit, por vetëm si veprim keqtrajtues, duke ushtruar masa fizike, pra duke i shkaktuar dhimbje fizike, rrahje me kablo të kompjuterit si dhe presion psikik – duke ia lidhur duart me izolir.

⁴ Po atë si në fusnotën numer 4,

Trupi gjykues pas vlerësimit të të gjitha provave konstatoi bindshëm se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet dhe elementet e veprave penale keqtrajtim apo braktisja e fëmiut nga neni 250 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK-së, për të cilat vepra i akuzuari është i përgjegjshëm andaj edhe e shpalli fajtor si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në kuptimin e veprës penale keqtrajtim i fëmijës i akuzuari ka ndërmarr veprime që i kanë tejkaluar kufijtë e “ ndëshkimit”, të karakterit edukativo disiplinor si prind ndaj fëmijës së tij, e që si masa që ndërmerr prindi ndaj fëmiut për të mos u konsideruar vepër penale duhet të jenë masa që nuk e dëmtojnë fëmiun, dhe të mos jenë të ndaluara me ligj, masat e tilla të jenë të kuptueshme, të arsyeshme dhe racionale, përkundrazi në veprimet e të akuzuarit këto janë tejkaluar dhe kanë konsistuar në keqtrajtim të fëmiut, në atë mënyrë që fëmija – i dëmtuari F.T. ka pësuar lëndime të rënda trupore, andaj edhe nga trupi gjykues u pranua kualifikim juridik i veprës si formë e cilësuar për shkak të pasojës së rëndë të shkaktuar nga kryerja e veprës penale të keqtrajtimit të fëmiut.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 i KPRK-së. Gjykata pati parasysh si rrethana rënduese mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe atë në prani apo afër fëmiut tjetër duke krijuar kështu një gjendje shumë të rëndë emocionale edhe te i dëmtuari si fëmijë por edhe te fëmiu tjetër që ka qenë prezent, ndërkaq si rrethana lehtësuese për të akuzuarin Gjykata ka gjetur se është prind i 2 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, por që prap se prap këto paraqesin dhe vlerësohen si rrethana minore krahasuar me rrethanat rënduese të rastit konkret.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion-raport me peshën e veprës penale, më përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe personalitetin e tij, dhe se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), dhe njëkohësisht me këtë do të arrihet edhe qëllimi tjetër, duke ndikuar edhe të

personat tjerë duke i ndaluar ne kryerjen e veprimeve të tilla të rrezikshme(preventiva gjenerale).

Në dënimin e shqiptuar të akuzuarit, i është llogaritur koha e qëndrimit në paraburgim konform nenit konform nenit 82 te KPRK-së, kurse në kuptim të nenit 367 par. 3, 6, 7 të KPPK-së, me aktvendim të veçantë i është vazhduar paraburgimi derisa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPK-së.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike është i bazuar në nenin 463 par. 2 të KPPK-së, në atë mënyrë që gjykata palën e dëmtuar e ka udhëzuar në tërësi në kontest civil për ta realizuar kërkesën pasurore juridike.

Nga arsyet e cekura me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PËR TË MITUR,
PKR.nr. 208/2014 me 23.01.2015.**

Sekretarja juridike,

F. Jakupi

Kryetari i Trupit Gjykues për të Mitur,

Kadrije Goga-Lubishtani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, nga data e pranimin të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës themelore në Ferizaj.